

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KRU Hidrodrini SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr. i Prokurimit <sup>1</sup>	<b>HIDRO-26-549-1-3-6</b>
Nr i brendshëm	<b>Hidro 26 003 136</b>

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me kemikate për fundërrues në Klinë (Sulfat Alumini Al<sub>2</sub>SO<sub>4</sub> x nH<sub>2</sub>O)**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**INFINITT SH.P.K.**

*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

Rr.28 Nentori, no.121

*(Adresa)*

Prishtinë

*(Vendi)*

044/974-590

*(Numri Telefonit)*

10.000

*(Kodi postar)*

/

*(Numri i Faks-it)*

Astrit Uka- menaxher

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë)*

[Infinit.shpk@gmail.com](mailto:Infinit.shpk@gmail.com)

*(Adresa elektronike)*

01.06.2026.

*(Data e parashtrimit të ankesës)*



*(Nënshkrimi dhe vula)*

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

/ \_\_\_\_\_  
(Emri i avokatit)

/ \_\_\_\_\_  
(Adresa e plotë)

/ \_\_\_\_\_  
(Numri i Telefonit)

/ \_\_\_\_\_  
(Numri i faks-it)

/ \_\_\_\_\_  
(Adresa elektronike)

/ \_\_\_\_\_  
(Data e parashtrimit të ankesës)

/ \_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

Njoftimi për kontratë: 20.02.2026.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertav: 26.02.2026.

Data dhe ora e hapjes së ofertav: 26.02.2026. ora 13:00

Njoftimi mbi vendimin e AK në rivlerësim: 24.04.2026.

Kriter për dhënie të kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me cmimin më të ulët

Pas dorëzimit të kërkesës për ri-shqyrtim lenda është kthyer në rivlerësim

Njoftimi mbi vendimin e AK në rivlerësim me 13.05.2026.

Kriter për dhënie të kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me cmimin më të ulët

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po

Jo

Procesverbalin e hapjes së ofertav e kemi pranuar në e-prokurim

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

Letren standarde per tenderuesin e eleminuar se bashku me njoftimin mbi vendimin e AK i kemi pranuar ne e-prokurim me 18.05.2026.

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.*

Kerkesen per ri-shqyrtim te AK kemi dorezuar me 13.05.2026.

Njoftimi per pezullimin e aktivitetit te prokurimit 19.05.2026.

Vendimin per refuzim te kerkeses per ri-shqyrtim e kemi pranuar 21.05.2026.

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Neni 1- Qellimi

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 28- Specifikimet teknike

Neni 52.3- Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës

Neni 56.3- Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 59.4- Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi I tendereve

Neni 60- Kriteret per dhenie te kontrates

Neni 65- Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Neni 67.2- Provat Shkresore

Neni 69- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

*Këto terme janë përdorur shumë herë në tekstin e mëposhtëm prandaj edhe i kemi përdorur shkurtetat që kanë domethënie si në vijim:*

*AK- Autoritet Kontraktues*

*OE- Operator Ekonomik*

*LPP- Ligji i prokurimit publik*

*UOPP- Udhëzimi operativ për prokurim publik*

AK/Komisioni vlersues gjatë ri-vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Udhëzimin operativ për prokurim publik.

AK/zyra e prokurimit me 13.05.2026. ka nxjere njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues ne ri-vleresim dhe ka rekomanduar per kontrate OE Seykos sh.p.k.

Me 14.05. kemi derguar kerkese per qasje ne dokumente zyrtare dhe me 15.05. AK na ka ofruar qasje sipas kerkeses sone.

Nga dokumentet te cilat kemi pranuar ne qasjen ne dokumente zyrtare konstatojme se OE i rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjshem per arsyejet si ne vijim:

- OE nuk ka plotesuar paramasen si duhet, OE ne paramase ne kolonen k titullin prodhues ka cekur Aluminium Sulphate ndersa ne dokumentet e ofertes autorizim, deklarate etj prodhuesi eshte cekur IMPULS – HEMIJA D.O.O Serbi, ne kete menyre OE eshte i papergjegjshem dhe eshte dashur te eleminohet pasiqe ka paraqitur dy prodhues ne paramase.

- OE nuk ploteson kriterin nr.2 lidhur me kapacitetin teknik&profesional ku eshte kerkuar

Kerkesa nr 2 Katalog apo prezantime grafike (vizatimet) dhe ose fotografi të produkteve për artikujt që ju ofertoni (për pozicionin 1.1 dhe 1.2)

Deshmia për kërkesen nr 2 Dokumentacionin autentik i prodhuesit si katalog pjesë të katalogut nga prodhuesi apo vizatim të vërtetuar nga prodhuesi me përshkrime teknike, detale për artikujt që ofertoni. Në katalog pjesë të katalogut apo vizatim sipas specifikimeve teknike të kërkuara, të nënvizohen artikujt për pozicionet e kërkuara.

Nëse në katalogë nuk janë të specifikuar të gjitha informacionet e kërkuara në përshkrimin teknik atëherë le të të lëshohet një letër e vulosur nga prodhuesi mbi të dhënat e specifikacionit të kërkuara nga ana e autoritetit kontraktues ku tregohen të dhënat me të detajuara te materialeve që ofroni.

OE nuk ka dorezuar katalogun për sulfat alumini por vetëm një dokument me emër specifikimet teknike i cili është leshuar me 23.09.2025. ende pa u publikuar ky aktivitet i prokurimit pra nuk i takon këtij aktiviteti të prokurimit, AK ka mund të perdore nenin 72.3 pasiqe jane dorezuar specifikimet teknike te kerkoje katalogun mirepo pa katalog jo ne kete forme jashteligjshem te shpallet fitues OE i papergjegjshem. OE ka dorezuar

edhe nje dokument Safety data sheet ne te cilin ka me shume informata per perdorimin dhe formen e transportit per keto materie.

OE i rekomanduar per kontrate nuk ploteson kerkesat e pershtatshmerise konform paragrafit 5 te nenit 65 te LPP-se.

OE ka dorezuar vertetimin e ATK-se leshuar me date 10.03.2026. ku thuhet se Personi është i regjistruar në ATK dhe aktualisht nuk ka borgje te pashlyera.

Ne kete menyre OE nuk ka ofruar deshmi konform nenit 65.5 te LPP-se, citoj:

5. Periudhat kohore të përcaktuara në këtë Nen ndërlidhen me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin ftesës për pjesëmarrje ose tenderim.

Ne kete menyre OE nuk ka arritur te paraqese deshmi se ne momentin e ofertimit ne kete menyre eshte i papergjegjshem pasiqe nuk ka ofruar deshmi se ne momentin e ofertimit ka qene i pergjegjshem sipas nenit 65 te LPPse.

Në këtë aktivitet të prokurimit, data e hapjes se ofertav është 26.02.2026, ndërsa vertetimi tatimor i dorezuar nga OE i rekomanduar per kontrate mban datën 10.03.2026, çka nënkupton se eshte leshuar pas datës se hapjes se ofertav dhe nuk pasqyronë gjendjen faktike të pranueshmërisë së tenderuesit ankues në momentin apo afatin e kërkuar.

Si i tille, ky dokument nuk mund të konsiderohet dëshmi e vlefshme dhe eshte në kundërshtim me kërkesat për pranueshmëri të përcaktuara nga AK.

Në përputhje me nenin 65 paragrafi 5 i Ligjit për Prokurimin Publik, periudha kohore në të cilën Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kriterin e “pranueshmërisë” lidhet drejtpërdrejt me periudhën që menjëherë i paraprin datës së publikimit të njoftimit për kontratë.

Kjo dispozitë ligjore nënkupton se Operatori Ekonomik duhet të jetë i pranueshëm pikërisht në datën e publikimit të njoftimit për kontratë dhe jo pas kësaj date.

Në rastin konkret, kërkesa e AK ka qenë e vendosur në përputhje të plotë me nenin 65, paragrafi 5 i LPP-së, ndërsa dokumenti përkatës Vertetimi i Administratës Tatimore të Kosovës do të duhej të ishin të lëshuara para ose deri ne ditën e hapjes se ofertav.

Dorëzimi i vertetimit tatimor pas kësaj date nënkupton se Operatori Ekonomik do të mund të bëhej “i pranueshëm” vetëm pasi të ishte vënë në dijeni për rezultatin e procedurës, gjë që është në kundërshtim me parimet e barazisë së trajtimit, transparencës dhe konkurrencës së ndershme në prokurimin publik.

Operatorët Ekonomikë të interesuar për këtë aktivitet të prokurimit duhet të jenë të rregullt në përmbushjen e obligimeve tatimore para datës së publikimit të njoftimit për kontratë, duke dëshmuar kështu stabilitetin dhe likuiditetin e tyre ekonomik.

Në përputhje me nenin 67, paragrafi 2 të LPP-së, AK ka obligim ligjor të vlerësoj të papërgjegjshëm çdo tenderues i cili nuk paraqet certifikatat apo dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar se nuk shkualifikohet sipas nenit 65 të këtij ligji.

Nga shqyrtimi i fakteve rezulton se tenderuesi ankues nuk ka dorëzuar dëshmi në pajtim me kërkesat e nenit 65 të LPP-së, ashtu siç janë kërkuar në Njoftimin për Kontratë dhe DT.

Poashtu citojme interpretimin e KRPP-se tek pyetje&pergjigje te shpeshta, interpretimi i dates 22.11.2022.

*6. 22.11.2022 A duhet OE me rastin e dorëzimit të ofertës të dëshmojnë se nuk janë në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së?*

*Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjet e parashtruara, KRPP ofron interpretimin ligjor të nën paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, si në vijim: Paragrafi 4.8 i nenit 65 te LPP përcakton: 4.8 “aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për*

sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë;” Në kuptim të paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, termi “aktualisht” nënkupton çdo herë që kërkohet në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë dëshmi për të vërtetuar se OE nuk është në vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë, OE duhet të sjellë dëshminë për të vërtetuar se një gjendje e tillë nuk ekziston.

Për këtë qëllim, në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë kërkohet nga të gjithë OE-të të interesuar për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit që të deklarojnë se janë “të pranueshëm” për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit. OE- të janë “të pranueshëm” kur ata ofrojnë së bashku me tenderin e tyre dëshminë “Deklaratën nën betim” me të cilën deklarojnë se një gjendje e tillë nuk ekziston. Kur OE rekomandohet për dhënie të Kontratës, para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK-se, nga i njëjti kërkohet dëshmia “Vërtetimi nga ATK” dhe për të qenë “i pranueshëm” OE sipas nenit 65 të LPP-së, duhet të vërtetojë se nuk është në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së. Në përputhje me paragrafin 5 të nenit 65, periudha kohore, se në cilën periudhë duhet të jetë OE i “pranueshëm”, ndërlidhet me periudhën që menjëherë paraprind datën e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të thotë se OE duhet të jetë i “pranueshëm” në datën e publikimit të njoftimit. Borxhet mund të lindin në periudha të ndryshme p.sh. gjatë procesit të vlerësimit, gjatë fazës së ankimit, prandaj ky nen përcakton kohën kur OE duhet të jetë i pranueshëm. Nisur nga fakti se shumë OE kanë marrëveshje për shlyerje të borxheve me ATK-në, KRPP sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës. Qëllimi i këtij neni është që OE duhet të jetë gjithmonë “i pranueshëm”, pra OE nuk duhet të ketë obligime të pashlyera në kohën e publikimit të Njoftimit për kontratë.

Pasiqe jemi ballafaquar me situatë të njejte ne të kaluarën ne kemi kërkuar interpretim nga KRPP lidhur me këto qeshtje dhe po ju bashkangjesim interpretimin e KRPP-se të datës 12.03.2026. për të faktuar këto qeshtje.

Ne anën tjetër AK pa të drejtë ka eliminuar ofertën e kompanisë sone megjithatë kemi plotësuar të gjitha kushtet/kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit VEREJA CHIM LTD dhe CONTINVEST LTD është e njejta kompani, poashtu të dhënat e prodhuesit të cilat mungojnë në autorizim AK ka mund të verifikojë duke kontaktuar prodhuesin e jo të shpërblejë me kontratë OE me cmim 75% me të lartë se oferta e kompanisë sone.

AK me 04.05. ka aprovuar pjesërisht kërkesën për ri-shqyrtim dhe ka kthyer lenden në ri-vlerësim por edhe pas ri-vlerësimit të ofertave është rekomanduar për kontratë OE i njejte i cili nuk ka dorezuar dëshmitë për plotësimin e kërkesave të pershtatshmerisë konform nenit 65.5 të LPP-se.

AK jashtëligjshëm ka kërkuar sqarime shtese duke kërkuar plotësimin e dokumenteve përkatësisht ndryshimin e tyre, që paraqet ndryshim material dhe nuk është i lejueshëm konform nenit 59.4 të LPP-se

1. OE nuk ka ofruar dëshmi se në momentin e ofertimit ka qenë i përgjegjshëm përkatësisht ka plotësuar kërkesën Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat **mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë**, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundur, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Kjo dispozitë ligjore parasheh sqarimin e jo ndryshimin e dokumenteve, prandaj AK është dashur të eliminojë OE në fjalë si të papërgjegjshëm.

Poashtu dëshmitë e dorezuara për pikan d janë të papranueshme pasi që përmbajnë datën 21.04.2026. dhe OE nuk ka dorezuar vërtetimin për shlyerjen e obligimeve ndaj

ujesjellesit, ju bashkangjesim me ankese nje forme te vertetimit te cilin e leshon KRU Prishtina

**d. Për situatën referuar pikës k) certifikate e lëshuar nga autoriteti kompetent apo operatori publik që një situatë e tillë nuk ekziston.**

**d. Vertetim Fatura dokumenti mbi paguajt. të harxhuar ose një kontratë në mes palëve, Ujësjesit dhe Operatori Ekonomik dëshmon se pagesa e këtyre shërbimeve bërë rregullish.**

Mare parasysh faktet e lartecekura konstatojme se AK/komisioni vleresues jashteligjshem ka rekomanduar per kontrate OE Seykos shpk i cili ne baze te deshmive te dorezuara eshte i papergjegjshem dhe kompania jone eshte eliminuar per detaje te cilat kane mund te sqarohen pa ndryshuar kushtin material apo ndonje apsket tjeter te tenderit.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Si pasoje e shkeljeve te lartecekura nga AK/komisioni vleresues ka ardhë deri tek dhenia e kontrates per OE te papergjegjshem ne kete menyre nuk jane respektuar dispozitat ligjore te lartecekura.

Kompanise sone si oferta e pergjegjshem me cmimin me te ulet i eshte mohuar fitimi i paramenduar nga kjo kontrate dhe eshte demtuar buxheti i shtetit perkatesisht KRU Hidrodrini per 3687.50euro.

Kerkojme nga Organi shqyrtues i prokurimit qe pas shoshitjes se provave dhe fakteve te aprovoje ankesen e kompanise sone si te bazuar dhe lenda te kthehet ne ri-vleresim, ri-vleresimi i ofertave nga AK te behet ne harmoni me kriteret/kerkesat e parashtruara ne njoftimin per kontrate dhe ne dosjen e tenderit.

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*